



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.18/2018

Prishtinë, më 18 prill 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Frashër Krasniqi dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Jahja Lluka-ZKM; Prenk Gjetaj-ZKM-KQPZH; Kushtrim Gara-ZKM-KQPZH; Ahmet Graiçevci-KKAFPZH; Besian Bajrami-Ekonomia Online; Drita Vitia-Radio Kosova.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
2. Diskutimi lidhur me shënimin e Javës së Personave të Pagjetur në Kosovë.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 26 dhe 29 mars 2018, u miratuan pa vërejtje.

2. Diskutimi lidhur me shënimin e Javës së Personave të Pagjetur në Kosovë

Kryetarja, tha se në këtë mbledhje do të diskutojmë lidhur me shënimin e Javës së Personave të Pagjetur në Kosovë. Të pranishëm kemi edhe personat përgjegjës nga Qeveria. Si komision kemi idenë që aktivitetet për shënimin e kësaj jave të fillojnë nga Kuvendi i Kosovës dhe duhet të ftohen të gjitha institucionet. Për këtë aktivitet, ne do të mundohemi të bëjmë më të mirën e mundshme.

Teuta Haxhiu, tha se meqenëse po i afrohem datës 27 prill dhe kjo ditë, me vendim të Kuvendit, është shpallur si Dita e Personave të Zhdukur në Kosovë, andaj edhe i takon Kuvendit, që të gjejë modalitetin që nisma e shënimit të kësaj date të bëhet nga Kuvendi. Ajo tha se fatkeqësisht ende nuk ka diçka konkrete për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për personat e zhdukur, që është kërkesë e familjarëve të personave të zhdukur, por edhe e Komisionit Funkcional.

Lidhur me çështjen e plotësim-ndryshimit të ligjit në fuqi, të dërgojmë një mesazh të përbashkët, në mënyrë që të gjejmë rrugën më të shpejtë, për ta ndryshuar dhe plotësuar këtë ligj, sepse është një kërkesë legjitime.

Më tej, ajo tha se sa herë që marrin pjesë në shënimin e ndonjë akademie përkujtimore, para familjarëve, asnjëherë nuk përdorim termin viktimë civile, por martir. Ligji nuk i njeh si martirë, por si viktima civile dhe me këtë nuk pajtohem dhe kërkoj nga komisioni qeveritar që të punojmë dhe të bëjmë hapa konkretë dhe të veprojmë sa më shpejt.

Kryetarja, tha se ka informacione nga ana e Qeverisë se Projektligji për personat zhdukur do të bëhet në qershor. Në komision kemi qenë të gatshëm të marrim nismën për ta bërë këtë projektligj, por për këtë do të bisedojmë prapë, se cila është zgjidhja më e favorshme.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se këto ditë janë të rënda për të gjithë, jo vetëm për familjarët që kanë të zhdukur anëtarë të familjes. Ka pasur përpjekje për zgjidhjen e kësaj çështjeje, por rezultatet konkrete nuk janë të dukshme.

Legjislaturën e kaluar kam kërkuar që zbardhja e fatit të personave të zhdukur të jetë temë në bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por nuk është realizuar deri më tani, edhe pse përpjekjet janë për ndryshime pozitive.

Lidhur me iniciativën për ndryshimin e Ligjit për personat e zhdukur, pajtohem për këtë çështje, gjithashtu edhe për cilësimin e viktimës civile si martir. Nëse ky ligj nuk ndryshohet nga Qeveria, atëherë jemi të gatshëm që këtë punë ta bëjmë në komision.

Saranda Bogujevci, njoftoi se së bashku me deputetin Andin Hoti, janë në proces të kërkimit të një debati parlamentar, jo vetëm për të shënuar si datë, por të dalim edhe me rekomandime, që do të ndihmonin në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, në një të ardhme të afërt.

Duda Balje, tha se ishte në takim me Qendrën Burimore për Persona të Pagjetur dhe ata kanë disa propozime konkrete, dhe si kërkesë e parë, është kërkesa për ndihmë financiare dhe për lehtësira për regjistrim në universitete.

Jahja Luka, tha se para disa dite kanë bërë një raport të detajuar për aktivitetet që janë bërë. Theksoi se ai është angazhuar si bartës i dosjes dhe i koordinon punët me të gjithë aktorët që janë për çështjen e personave të zhdukur. Kjo punë është me shumë sfida, por shpresa duhet të

ekzistojë, puna dhe angazhimi ynë nuk duhet të mungojë. Instituti i Mjekësisë Ligjore menaxhohet prej EULEX-it, deri më tani EULEX, ka bërë punë shpeshherë pa dijen e institucioneve të Kosovës dhe tani nuk duhet të ndodhë kjo. Kam kërkesë nga Kryeministri që këto ditë të jemi sa më afër familjarëve, sepse fundi i marsit dhe prilli janë të dhimbshme për krejt Kosovën. Lidhur me këtë, kemi përpiluar edhe një agjendë pre Javën e të Zhdukurve, e cila fillon më dt.23 prill, me homazhe te Lapidari në oborrin e Kuvendit. Më tej, tha se është i interesuar që deputeti Andin Hoti, të marrë pjesë në aktivitetet e tyre. Ai shtoi se kanë pasur takim me familjarët e serbëve të zhdukur, janë tri shoqata në Kosovë dhe janë zotuar se të gjithë ata që respektojnë ligjin e Kosovës do të trajtohen barabartë, me gjithë të tjerët.

Në Kosovës ka rreth 100 familjarë që nuk kanë dhënë mostrat e gjakut, për të bërë ADN-në dhe kemi kërkuar nga EULEX, të na japë listën e këtyre familjarëve dhe të bëjmë përpjekje të kontaktojmë me të gjithë këta familjarë që t'i bindim për të dhënë gjakun dhe të kemi mundësinë të bëjmë ADN-në, që të kontribuojmë në gjetjen e familjareve të zhdukur.

Jemi në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që projektligjet nga kjo fushë, të plotësuara dhe të ndryshuara, të procedohen sa më parë që munden në Kuvend. Ai theksoi se jam për atë që familjarët e martirëve të kenë privilegjet e njëjta si të familjarëve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës.

Ai, më pas, përmendi një rast nga Krusha, ku janë nxjerrë tri mbetje mortore dhe që nuk janë kthyer për 1 vit, për shkak të mosgatishmërisë së përgjegjësve të EULEX-it. E kemi diskutuar këtë çështje me persona përgjegjës dhe besoj shumë shpejt do të kthehen. Jemi dakorduar edhe me EULEX-in, se krejt çka iu duhet për të gërmuar, ne jemi të gatshëm t'i marrim përsipër këto çështje, në bashkëpunim me komnat, mirëpo nuk do të lejojmë me e politizuar çështjen e personave të zhdukur. Por, një gjë duhet ta kemi të qartë të gjithë, se adresa për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur është Beogradi. Kemi bashkëpunim të mirë me Ambasadën e SHBA-ve dhe me atë Zvicerane, të Mbretërisë së Bashkuar dhe janë të gatshëm të na ndihmojnë. Po ashtu, tha se është në interes që të zgjidhet sa më shpejt drejtori i Departamentit të Mjekësisë Ligjore, pasi që dy herë ka dështuar konkursi. Sa i përket debatit parlamentar, tha se është mirë të jetë një debat i përgatitur mirë, i qetë dhe i arsyeshëm.

Kryetarja, tha se ka pasur mundësi të lexojë në disa media të Beogradit, se është marrë vendim për ndërtimin e një kisha në Batajnicë, ku thuhet se ka më shumë se 100 trupa të shqiptarëve dhe ndoshta më shumë se 75 trupa të fëmijëve, këto janë informata nga ana e Serbisë. A i kemi në institucionet e Kosovës këto informata dhe a kemi mundësi për të biseduar me Serbinë, për ndaljen e këtij procesi? Ose, sa mundemi që ne si komision, të bëjmë një

reagim që Ambasada e SHBA-ve dhe faktorë të tjerë, të ndikojnë në ndalimin e ndërtimit të kishës në Batajnicë.

Jahja Lluka, tha se bashkëpunim me Serbinë, thajse nuk kemi fare, sepse ata çështjen e bisedave e kanë sa për të thënë se jemi duke biseduar, pa asnjë rezultat konkret. Gabimi i institucioneve të Kosovës është që nuk kanë ngritur padi për gjenocid ndaj Serbisë dhe ju deputetët duhet të jeni më të zëshëm në këtë drejtim, sepse kemi fakte, kemi dokumentacione.

Saranda Bogujevci, tha se para një apo dy viteve ka qenë një iniciativë prej disa organizatave në Serbi, për ndërtimin e një memoriali në Batajnicë dhe duhet parë mundësinë se si mundemi që të ndihmojmë në këtë proces.

Prenk Gjetaj, tha se Batajnica është kompleks i madh ushtarak dhe varet se në cilën pjesë është paraparë ndërtimi. Në Batajnicë janë eksumuar 742 trupa, nga Serbia janë riatdhesuar 902 trupa, përfshirë Batajnicën, Petrovosellen, Bajnabashten, në qendrën e Peruqasit, në kufi me Bosnjën dhe së fundmi në Rudnicë.

Më tej, theksoi se ka qenë iniciativë e familjareve të personave të zhdukur, që të vendoset pllakë përkujtimore në vendet ku ka pasur gjetje. Këtë do ta procedojmë në kuadër të dialogut që zhvillohet me palën serbe, me ndërmjetësimin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.

Nëse do të kemi informatë se ku është paraparë ndërtimi i kishës në Batajnicë, atëherë do të reagojmë. Sa i përket shënimit të Javës së Personave të Pagjetur, duhet të jemi të koordinuar, theksoi ai.

Deputeti Andin Hoti, tha se e kuptoj që nuk keni bashkëpunim me Serbinë, por përmes miqve ndërkombëtarë të gjejmë një formë që, nëse është paraparë një ndërtim i tillë i një kishë, të bëhet presion dhe të ndaloher.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është jetike të ndryshohet dhe të plotësohet Ligji për persona të zhdukur. Kemi pasur takim edhe me familjarë të personave të zhdukur, ata kanë edhe propozime për përfshirje në draftimin e projektligjit.

Në Kuvend, së shpejti do të mbahet debat parlamentar për të zhdukurit dhe sigurisht do të dalin rekomandime, por çështja është se çfarë mund të bëjë Qeveria, a mund t'i lëvizë rekomandimet që do të dalin nga ai debat në seancë.

Lirije Kajtazi, pyeti: Sa janë transferuar dosjet nga EULEX te vendorët? Si komision i veçantë, a keni kërkuar që të ndahet edhe një pjesë e buxhetit për ngritjen profesionale të kuadrit, përfshirë antropologët?

Më pas, theksoi se disa anëtarë të Komisioni FunkSIONAL kemi qenë në takim me përfaqësues të Mbretërisë së Bashkuar dhe çështjen e të pagjeturve e kemi ngritur edhe në atë takim, ndërsa ata kanë shprehur gatishmërinë për mbështetje.

Jahja Lluka, tha se rekomandimet e nxjerra nga Kuvendi, për Qeverinë e Kosovës, do të jenë obliguese.

Ne kemi antropologë, por udhëheqësia e morgut dhe instituti që udhëhiqet nga EULEX-i, nuk kanë vullnet që t'i avancojnë çështjet.

Ai, në fund, informoi anëtarët e komisionit se në Samitin e Londrës, që do të mbahet në korrik të këtij viti, do të jetë temë, çështja e të zhdukurve.

Kryetarja konstatoi se komisioni, të hënën, më dt.23 prill, në orën 9:00, do të vendosë lule te Lapidari, para Kuvendit dhe në emër të komisionit, para mediave, për këtë çështje do të prononcohet anëtarja e komisionit, Saranda Bogujevci.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje